

Në seancën përgatitore përfaqësuesi i paditëses deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkespadiisë si dhe i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i paditëses në seancën përgatitore të dt.13.03.2013 dhe në fjalën perfundimtare deklaroi se mbetet pranë padisë dhe kërkespadiisë, ndërsa e paditura nuk prezantoi edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsytuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata administroi këto prova: kontrata për pagimin e borxhit e dt.25.03.2009, pasqyra e llogarisë së pagesës e dt.13.01.2010, kopja e letërnjoftimit.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi në pajtim me nenin 7 dhe 8 të LPK-së dhe erdhi në këto konkludime:

Nuk është kontestues fakti se e paditura ka qenë shfrytëzuese e shërbimeve telefonike, pasi kjo vërtetohet edhe nga ana e nënshkrimit të kontratës mbi pagimin e borxhit.

Nuk është kontestuese se e paditura i ka paditëses borxh, pasi një gjë të tillë gjykata e vërteton pikërisht në bazë të kontratës mbi pagimin e borxhit me këste, ku me nënshkrimin e kontratës ajo e pranon borxhin, ndërsa edhe pas nënshkrimit të kontratës e paditura ka krijuar shpenzime të tjera ku kjo vërtetohet pikërisht nga fakti përmes pasyres së llogaris së pagesës.

E paditura edhe pse ishte ftuar me rregull në seancë mungesën nuk e kishte arsytuar, andaj gjykata vlerësoi se në bazë të provave që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohen pretendimet e paditëses, dhe në të njëjtën kohë vërtetohet bazueshmëria e kërkespadiisë së paditëses.

Sa i përket shpenzime procedurale gjykata u bazoi në nenin 452 paragrafi I të LPK-së, ku pala e cila e ka humb kontestin duhet t'ia paguajë palës tjetër shpenzimet procedurale.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.Nr.06/2010 datë: 20.05.2013



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 7 ditor nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë - nëpërmjet kësaj gjykate.